

Udhëzim nga Fjala e Perëndisë

67 Prova që mund të përdoren nga një besimtar për të vendosur gjatë një sërë veprimesh



PARIME BIBLIKE MBI UDHËZIMIN

Hyrje

DUHET apo nuk duhet? Jeta është e mbushur plot me vendime. A duhet të bëj një gjë të caktuar? A duhet të shkoj në një vend të caktuar? A duhet të marr pjesë në një aktivitet të caktuar?

Ata që janë besimtarë në Krishtin kanë një standard të mrekullueshëm objektiv të së vërtetës i cili mund të drejtojë sjelljen tonë dhe të udhëheqë jetët tona në një mënyrë që i pëlqen Shpëtimtarit tonë. Thirrja e zëmrës së psalmistit ishte kjo: “Stabilizoi hapat e mia sipas fjalëve të tua dhe mos lejo që asnjë paudhësi të më sundojë” (Psalmi 119:133). Jetët tona, veprimet tona, vendimet tona duhet të rregullohen dhe të drejtohen nga Fjala e Perëndisë.

Në shumë, shumë fusha Fjala e Perëndisë nuk është specifike. Në vend të kësaj Bibla na jep parime të qarta dhe udhëzime të sigurt të cilat në qoftë se kuptohen dhe zbatohen në mënyrën e duhur do tu përgjigjen çdo pyetjeje specifike. Problemi është se shpesh ne dështojmë ose neglizhojmë që t’i zbatojmë parimet dhe tu bindemi udhëzimeve që Zoti na ka dhënë.

Në këtë studim ne kemi paraqitur 67 PROVA me anë të të cilave ne mund të vendosim se çfarë hapash veprimi duhet të ndërmarrim. Kjo nuk ka si qëllim të jetë një listë shteruese. PROVA të tjera mund t’i shtohen asaj. Shumica e këtyre udhëzimeve janë marrë nga letrat e Dhjatës së Re. Patjetër që shumë udhëzime të tjera ose “prova” mund të gjenden në Ungjijtë, në librin e Fjalëve të Urta dhe tjetërkund në Bibël.

Asnjë nga këto prova nuk mund të na bëjë ndonjë dobi po të mos i zbatojmë ato me të vërtetë. Me dëshirën për t’i pëlqyer Krishtin në gjithçka që bëjmë, le t’i vëmë në provë veprat dhe veprimet tona me anë të këtyre udhëzimeve nga Dhjata e Re.

(Shënim: Këto “prova” janë paraqitur në një renditje sipas Dhjatës së Re në mënyrë që vargjet të mund të gjenden më lehtë.)

1. Prova e Shkrimeve (Isaia 8:20; 1 Thesalonikasve 5:21)

A e ndalon Shkrimi atë? A jam urdhëruar për të mos e bërë?

2. Prova e Administrimit (Luka 16:9-12)

A do të përfshinte kryerja e këtij veprimi një shpërdorim apo keqpërdorim të parave, zotërimeve dhe kohës që

Perëndia më ka besuar?

3. Prova e Veçimit / Ndarjes (Romakëve 1:1)

A është ky veprim ose aktivitet në përputhje me një jetë që është e veçuar për ungjillin e Perëndisë?

4. Prova e “Gjymtyrëve Trupore” (Romakëve 6:13)

Në kryerjen e këtij veprimi a po paraqiten gjymtyrët e mia trupore si mjete drejtësie për Perëndinë apo po përdoren në një mënyrë që nuk e nderon Perëndinë i Cili më zotëron dhe të Cilit unë i shërbej?

5. Prova e Urrejtjes (Romakëve 12:9; cf. Juda 23)

Kryerja e këtij veprimi a do ta bëjë, në çfarëdo mënyre, të paqartë faktin që unë e urrej mëkatin dhe e kam krupë [d.m.th. më vjen neveri] nga e keqja dhe që duhet të largohem nga ajo (1 Pjetrit 3:11) me çdo kusht?

6. Prova e Dashurisë (Romakëve 14:15)

Në kryerjen e këtij veprimi a jam duke ecur sipas dashurisë? A jam duke kërkuar më të lartën dhe më të mirën e Perëndisë për ata persona me të cilët jam përfshirë?

7. Prova e Ndërgjegjes (Romakëve 14:22, 23)

A mund ta bëj unë atë veprim me një ndërgjegje të shëndoshë dhe të qartë? (Besimtari nuk duhet të bëjë kurrë atë që ndërgjegjja e tij ia ndalon. Ndërgjegjja e besimtarit mund të ketë nevojë të korrigohet dhe të jetë më shumë e më shumë në harmoni me Fjalën e Perëndisë, por nuk është kurrë e sigurt që dikush të veprojë kundër ndërgjegjes së tij dhe që në mënyrë rebele të bëjë atë gjë për të cilën zemra e tij e dënon). Kur je në dyshim, MOS E BËJ?

8. Prova “Kujt jam duke i pëlqyer?” (Romakëve 15:1, 2)

Po e bëj këtë gjë për t'i pëlqyer vetes apo të tjerëve?

9. Prova e Zjarrit (1 Korintasve 3:11-15)

A do të ndërtojë kjo gjë mbi atë që do të zgjasë përgjithmonë apo kontributi i saj do të jetë thjesht dru, sanë dhe kashtë të cilat do të digjen krejt në gjyqin e Krishtit?

10. Prova e Dobisë (1 Korintasve 6:12; 10:23)

A është e dobishme, e leverdisshme, dobiprurëse të bësh një gjë të tillë? (Kjo është më mirë se të pyesësh “A është e lejueshme?”)

11. Prova e Skllavit (1 Korintasve 6:12)

Nëse e bëj a do të bëhem unë një skllav ndaj ndonjë gjëje? A do të më bëjë ajo gjë një skllav? Mos vallë ajo gjë do të më lidhte mua dhe kështu unë nuk do të isha i lirë për t'i shërbyer siç duhet Shpëtimtarit tim?

12. Prova “Tempulli i Perëndisë” (1 Korintasve 6:19, 20)

A do ta lëndonte ajo gjë trupin tim? A do të nderohej Perëndia me mënyrën sesi unë e përdor trupin tim? A do t'i çlodhnin dhe forconin këto veprime trupin dhe trurin tim apo do t'i lodhnin dhe dobësonin ato? Nëse shpenzohem

[d.m.th. e përkushtoj vetveten] deri në kulmin e rraskapitjes fizike a është kjo për një kauzë të mençur dhe të drejtë, madje edhe kur bëhet fjalë për kauzën e Krishtit (2 Kor. 12:15).

13. Prova e Shkëputjes (1 Korintasve 7:35)

A do të më shkëputë mua kjo nga të shërbyerit ndaj Zotit? A do të më pengojë që t'i pëlqejë Zotit?

14. Prova e Skandalizimit (1 Korintasve 8:13; 10:32; Romakëve 14:21)

A do të skandalizonte një person kryerja e kësaj gjëje? A do të pengonte në çfarëdo mënyre rritjen e një besimtari tjetër? A do të pengonte në çfarëdo mënyre një person të pashpëtuar që ai të njihnte Krishtin si Shpëtimtar?

15. Prova e Misionarit (1 Korintasve 9:19-22; 10:33; cf. 2 Timoteut 2:10)

A do të inkurajojnë veprimet e mia të tjerët të njohin Krishtin si Shpëtimtar? A do t'i pengonin apo largonin ato në çfarëdo mënyre nga Krishti dhe ungjilli i Tij? A do t'i ndihmonin ato të tjerët të njihnin Zotin Jezus Krisht si Shpëtimtar?

16. Prova e Idhujtarisë (1 Korintasve 10:7, 14; 1 Gjonit 5:21)

Duke bërë këtë veprim a jam duke lejuar diçka ose dikë që të jetë për mua më i rëndësishëm se Perëndia?

17. Prova e Ndërtimit (1 Korintasve 10:23; 14:26)

A do të ngrinte dhe ndërtonte kjo gjë një besimtar tjetër? A do të nxisnin veprimet e mia rritjen në Zotin të tjetrit?

18. Prova e Egoizmit (1 Korintasve 10:24; 13:5)

Po e bëj këtë gjë për t'i pëlqyer dhe shërbyer vetvetes apo të tjerëve? A jam duke jetuar për vetveten apo për Zotin (Rom. 14:7; 2 Kor. 5:15).

19. Prova "Lavdia e Perëndisë" (1 Korintasve 10:31)

A mund ta bëj atë për lavdinë e Perëndisë? Duke bërë këtë a jam duke paraqitur një ide të qartë të Perëndisë tim dhe se KUSH AI ESHTE?

20. Prova "Ndiqmëni" (1 Korintasve 11:1; Filipianëve 4:9)

A do të doja që të tjerët të më ndiqnin mua në këtë gjë? A do të doja që besimtarët e tjerë të më imitonin mua në këtë gjë? A mund t'ju rekomandoj këtë mënyrë veprimi atyre?

21. Prova e Shoqërisë (1 Korintasve 15:33; cf. 2 Korintasve 6:14; 1 Pjetrit 4:4)

Duke bërë këtë a do të futem unë në shoqëri kompromentuese me shokë të këqij (shoqëri të keqe) e cila do të ketë një ndikim degjenerimi dhe prishjeje mbi karakterin dhe parimet e mia morale?

22. Prova "Vepra e Zotit" (1 Korintasve 15:58; cf. 2 Korintasve 9:8)

A do të më pengojë kjo në çfarëdo mënyre ndaj të tepruarit në veprën e Zotit? A do të më pengojë kjo nga të shërbyerit me energji dhe zell të zjarrtë ndaj Zotit?

23. Prova e Përkohshme / Përrjetshme (2 Korintasve 4:18; Kolosianëve 3:1, 2)

A jam duke i bazuar vendimet e mia mbi realitete të përkohshme apo të përjetshme? A jam duke parë pamjen e shkurtër apo pamjen e gjatë? Ky vlerësim që po bëj bazohet në kohë apo në përjetësi? A jam duke e parë atë ashtu si Perëndia do ta shihte?

24. Prova e Gjyqit të Krishtit (2 Korintasve 5:10; Romakëve 14:10-12)

A do të më sjellë kjo turp (të bëjë që unë të turpërohem) në Gjyqin e Krishtit?

25. Prova e Arsyes (2 Korintasve 5:14)

A jam i motivuar [i shtyrë] nga dashuria e Krishtit apo nga lakmia e mishit?

26. Prova e Krijesës së Re (2 Korintasve 5:17)

A janë këto gjëra pjesë e jetës sime të vjetër (a janë ato pjesë e “gjërave të vjetra” të cilat kanë shkuar) apo janë pjesë e jetës sime të re në Krishtin?

27. Prova e Ambasadorit (2 Korintasve 5:20)

Duke bërë këtë a jam duke përfaqësuar Shpëtimtarin tim në një mënyrë të qartë dhe të padyshimtë?

28. Prova e Shenjtërimit (2 Korintasve 7:1, 2; 2 Timoteut 2:21)

A do të më shkaktonte kryerja e kësaj gjëje në çfarëdo mënyre të kompromentoja shenjtërinë personale? A do të më pengonte ajo në çfarëdo mënyre nga të qenit një enë e pastër dhe e veçuar për t'u përdorur nga Zoti?

29. Prova Mendore (2 Korintasve 10:5; cf. 11:3)

A do të më ndihmonte kjo për t'ia nënshtruar çdo mendim dëgjës [bindjes] së Krishtit apo do të më vendoste në atë vend ku mendja ime do të bombardohej me çdo lartësi që ngrihet kundër njohjes së Perëndisë?

30. Prova “Kujt duhet t'i pëlqej” (Galatasve 1:10)

Duke bërë këtë a jam duke kërkuar që t'i pëlqej Perëndisë apo njerëzve?

31. Prova “Korr atë që është mbjellë” (Galatasve 6:7)

A jam i gatshëm të korr pasojat e këtij veprimi?

32. Prova e Frymës së Shenjtë (Efesianëve 4:30; cf. 1 Thesalonikasve 5:19)

A e trishton (e pikëllon, i shkakton vuajtje) kjo gjë Frymën e Shenjtë të Perëndisë? Kryerja e kësaj gjëje a do të shuajë ose të pengojë në çfarëdo mënyre punën e Frymës së Shenjtë në jetën time?

33. Prova e Shenjtorit (Efesianëve 5:3; prova fëmijë i Perëndisë (Efe. 5:1), prova një krijesë e re (2 Kor. 5:17), qytetar i qiellit.

A jam duke vepruar në mënyrë të duhur dhe të përshtatshme për atë KUSH UNE JAM në Krishtin Jezus? A është kjo ajo që një fëmijë i Perëndisë do ta bënte? A është kjo ajo që një shenjtor do ta bënte? A është kjo ajo që një krijesë e re në Krishtin do ta bënte? Etj.

34. Prova e Miratimit Hyjnor (Efesianëve 5:10; 2 Korintasve 5:9)

A është e pranueshme për Perëndinë? Nëse e bëj këtë gjë a do të marr buzëqeshjen miratuese të Perëndisë dhe që Ai të më thotë “Të lumtë!”? (cf. Mat. 25:21, 23)

35. Prova e Kohës (Efesianëve 5:16)

A është ky përdorimi më i mirë i kohës? A është kjo mënyra më e mirë për t’i shpenzuar mundësitë që Perëndia më ka dhënë?

36. Prova e Nënshtrimit (Efesianëve 5:21)

Duke bërë këtë a jam unë duke iu nënshtruar atyre autoriteteve të cilët Perëndia i ka vendosur mbi mua?

37. Prova e Armatimit të Perëndisë (Efesianëve 6:10-18)

A do të më shkaktonte kryerja e këtij veprimi që unë të jem më i cënueshëm ndaj sulmeve e armikut?

38. Prova e më të Mirës (Filipianëve 1:10)

Ndoshta mund të jetë e pranueshme dhe e lejueshme për ta bërë këtë gjë, dhe madje ndoshta ajo mund të jetë një gjë e mirë për ta bërë, por a është ajo në të vërtetë GJEJA ME E MIRE?

39. Prova e Madhërimit (Filipianëve 1:20)

Duke bërë këtë a do të madhërohet Krishti nga unë?

40. Prova e Ungjillit (Filipianëve 1:27)

A do ta bënin të dyshimtë a ngatërronin, ose a do t’ia pakësonin vlerën mesazhit të lajmit të mirë të cilin unë dëshiroj që të tjerët ta njohin dhe ta besojnë?

41. Prova e të Konsideruarit si Pleh (Filipianëve 3:7, 8)

A jam i gatshëm të sakrifikoj dhe të heq dorë nga disa gjëra që janë të rëndësishme për mua për hir të Krishtit?

42. Prova e Gëzimit (Filipianëve 4:4)

A është gëzimi im në Zotin apo është në diçka a dikë tjetër? Nëse nuk do ta bëja këtë, a do të humbja gëzimin tim? Mos vallë jam duke kërkuar gëzim, lumturi dhe kënaqësi në burime të gabuara?

43. Prova e Mendimeve të Pastra (Filipianëve 4:8)

A do të më ndihmojë kjo që unë të kem mendime të pastra, të dobishme e të shëndosha apo do të më nxiste të zptohesha me mbeturina mendore?

44. Prova e të qenit i Kënaqur (Filipianëve 4:11; 1 Timoteut 6:6, 8)

Nëse nuk do ta bëja këtë gjë ose nuk do ta kisha këtë gjë, a do të mund të isha prapë i kënaqur?

45. Prova e Epërsisë (Kolosianëve 1:18)

Duke bërë këto a do t’i jepet Zotit Jezus vendi i parë në jetën time?

46. Prova në Emër të Krishtit (Kolozianëve 3:17)

A mund ta bëj këtë gjë në Emër të Zotit Jezus, duke e falenderuar? A do të dëshirojë Ai ta njëjtësojë Emrin e Tij me atë që unë po bëj?

47. Prova “Shërbëtor i Krishti” (Kolozianëve 3:23, 24)

A mund ta bëj unë atë gjë me dëshirë të mirë [d.m.th., me gjithë shpirtin tim] si për Zotin?

48. Prova e Dëshmisë së Mirë (Kolozianëve 4:5)

A do të lërë kjo një dëshmi të mirë ndaj të jashtëmëve [d.m.th., jobesimtarëve]?

49. Prova e Lutjes (1 Thesalonikasve 5:17; Lluka 18:1)

A do të pengonte kjo gjë në ndonjë mënyrë jetën time të lutjes ose a do ta bënte kjo gjë lutjen më të vështirë për mua?

50. Prova e Falenderimit (1 Thesalonikasve 5:18; Efesianëve 5:20)

A mund ta bëj këtë gjë me falenderim? A mund ta falenderoj Perëndinë me një ndërgjegje të pastër?

51. Prova e Dukjes (1 Thesalonikasve 5:22)

A do të linte një dukje të ligë ajo që unë bëj? A do të keqkuptoheshin apo dukeshin në një dritë negative veprimet e mia?

52. Prova e Modestisë (1 Timoteut 2:9, 10; 1 Pjetrit 3:3, 4)

Kryerja e kësaj a do të tërhiqte vëmendjen te unë apo te Krishti që është në mua? A do të shfaqja unë VETEN apo SHPETIMTARIN?

53. Prova “I Patëmetë” (1 Timoteut 3:1)

A do t'i jepte kryera e kësaj dikujt një rast për të drejtuar gishtin tek unë dhe për të më fajësuar për sjellje që nuk është në harmoni me besimin në Krishtin që unë deklaroj? (Shiko shembullin e lavdërueshëm të Danielit te Danieli 6:4).

54. Prova e të qenit Shembull (1 Timoteut 4:12)

Duke bërë këtë a do të jem unë një shembull i mirë i asaj se si duhet të jetë një besimtar?

55. Prova e Ngatërrimit (2 Timoteut 2:4)

A do të gjente kryerja e kësaj të zënë apo të ngatërruar “me punërat e kësaj jete” për shkak të neglizhencës [braktisjes] sime të përgjegjësive time parësore që është për t'i pëlqyer Krishtit?

56. Prova e Dëfrimdashjes (2 Timoteut 3:4)

A po e bëj këtë sepse dëshiroj kënaqësitë më tepër sesa dua Perëndinë? A jam duke e gjetur kënaqësinë në gjëra të tjera apo njerëz të tjerë më shumë se ç'është në Zotin (Psalmi 37:4)?

57. Prova e Ardhjes së Dytë (2 Timoteut 4:8; 1 Gjonit 2:28)

A do të doja që Zoti të vinte kur të jem duke bërë këtë gjë? A do të doja që kur Zoti të më gjente në këtë vend, të përfshirë në këtë aktivitet kur Ai të vijë?

58. Prova e Nderimit (Titit 2:10)

A do ta nderonte ky aktivitet mësimin e Perëndisë, Shpëtimtarit tim? Duke bërë këtë a do të zbuloheshin të vërtetat dhe parimet e Fjalës së Perëndisë në jetën time?

59. Prova “Të Mohojmë Pabesinë” (Titit 2:12; cf. 1 Pjetrit 2:11)

Duke marrë këtë vendim a jam unë duke i thënë “JO” në mënyrë të vendosur, të qartë dhe të padyshimtë pabesisë dhe lakmive të botës?

60. Prova e Pengesës (Hebrenjve 12:1, 2)

A do të më pengonte kryerja e kësaj në çfarëdo mënyre nga të vrapuarit në garë? A do të më rëndonte kjo gjë mua për të penguar që të vrapoj siç duhet?

61. Prova e Poshtërimin të Krishtit (Hebrenjve 13:13; cf. 11:26)

Duke marrë këtë vendim, çfarë është më e rëndësishme për mua (cila është ajo që unë vlerësoj më shumë) – miratimin e njerëzve apo poshtërimin e Krishtit?

62. Prova e Tundimit (Jakobi 1:13-16)

A e bën kjo qëndrueshmërinë ndaj tundimit më të lehtë apo më të vështirë?

63. Prova “Afrohuni te Perëndia” (Jakobi 4:8; cf. Hebrenjve 10:38)

A më afron apo më largon kjo gjë nga Krishti?

64. Prova e Rritjes (1 Pjetrit 2:2; 2 Pjetrit 3:18; cf. Hebrenjve 6:1-3)

Duke bërë këtë a do të pengojë apo mbysë kjo në çfarëdo mënyre rritjen time në Krishtin? A do të ndihmojë kjo për rritjen time në Krishtin?

65. Prova e Bashkësisë (1 Gjonit 1:3, 4)

Duke bërë këtë a do të më marrë kjo në çfarëdo mënyre gëzimin e të paturit bashkësi me Krishtin?

66. Prova e Botës (1 Gjonit 2:15-17; Jakobi 4:4)

A po kërkoj ta bëj këtë gjë në mënyrë TE PAVARUR (duke e lënë Perëndinë jashtë)?

67. Prova “Dashurinë e Parë” (Zbulesa 2:4)

Duke bërë këtë a do të jetë plotësisht e qartë se Jezus Krishti është dashuria ime e parë?

The Middletown Bible Church, 349 East Street Middletown, CT 06457 (860) 346-0907